



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
Komuna e Prishtinës  
Pristina Obstina-Municipality of Pristina



**SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT**

---

Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagrafi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 61 paragrafi 61.3. lidhur me nenin 63 paragrafin 63.1 nënparagrafin 63.1.2. pikën a) si dhe lidhur me nenin 62 paragrafin 1 nënparagrafin d) të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik "IMK Ballkan Projekt" Sh.P.K. të datës 06.03.2023 kundër njoftimit mbi vendimin – i korigjuar të datës 02.03.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Shërbime Laboratorike për ekzaminimin e materialeve ndërtimore" me nr. të prokurimit 616-22-14438-2-2-1 dhe nr. të brendshëm 616 22 210 221, Komuna e Prishtinës (autoriteti kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

**V E N D I M**

- I. **REFUZOHET** kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik "IMK Ballkan Projekt" Sh.P.K. të datës 06.03.2023 kundër njoftimit mbi vendimin të datës 02.03.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Shërbime Laboratorike për ekzaminimin e materialeve ndërtimore" me nr. të prokurimit 616-22-14438-2-2-1 dhe nr. të brendshëm 616 22 210 221.
- II. **AUTORIZOHET** autoriteti kontraktues – Komuna e Prishtinës që të vazhdoj me aktivitetin e prokurimit të përcaktuar në pikën I të këtij vendimi. Autoriteti Kontraktues, për nënshkrim të kontratës, duhet të pres se paku 10 ditë kalendarike me efekt nga dita pas datës në të cilën autoriteti kontraktues ka marrë këtë vendim.
- III. **NJOFTOHET** operatori ekonomik "IMK Ballkan Projekt" Sh.P.K. si dhe të gjitha palët tjera të interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën elektronike E-Prokurimi në adresën <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

## Arsyetim

Operatori ekonomik "IMK Ballkan Projekt" Sh.P.K. (tutje "parashtruesi) me datë 06.03.2023 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit mbi vendimin e autoritetit kontraktues - Komuna e Prishtinës të datës 02.03.2023 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Shërbime Laboratorike për ekzaminimin e materialeve ndërtimore" me nr. të prokurimit 616-22-14438-2-2-1 dhe nr. të brendshëm 616 22 210 221.

Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit është gjetur se kërkesa është e lejuar dhe është parashtruar brenda afatit nga personi i autorizuar si dhe nuk ekzistojnë pengesa tjera për të shqyrtuar kërkesën e parashtruesit. Në këtë mënyrë janë plotësuar kushtet për të vazhduar me shqyrtimin meritore (*in meritum*) të kërkesës.

Pretendimi i parashtruesit është si në vijim: "Me datën 02.03.2023 Autoriteti Kontraktues - Komuna e Prishtinës ka publikuar B58 Njoftimin mbi Vendimin e Autoriteti Kontraktues, ne OE IMK Ballkan Projekt Sh.P.K. Rekomandohet për kontratë...".

Për shkak të pretendimit si më sipër, parashtruesi konsideron se autoriteti kontraktues - Komuna e Prishtinës në këtë aktivitet të prokurimit ka vepruar në kundërshtim me nenin 1, 6, 7, 40, 41, 42, dhe 59 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik (tutje "LPP").

Autoriteti Kontraktues - Komuna e Prishtinës përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit me datë 10.03.2023 ka trajtuar kërkesën për rishqyrtim.

Me qëllim të shqyrtimit të pretendimeve të parashtruesit, janë administruar si prova Njoftimi për kontratë, raporti i vlerësimit nga komisioni vlerësues, njoftimi mbi vendimin e autoritetit kontraktues si dhe njoftimi për vendim i korigjuar i autoritetit kontraktues.

Pas analizimit të pretendimit të parashtruesit është gjetur se parashtruesi nuk ka paraqitur argumente të qëndrueshme dhe nuk ka dorëzuar dëshmi të mjaftueshme për të vërtetuar pretendimin. Rrjedhimisht pretendimi është i pabazuar pasi që nga provat e administruara mund të vërtetohet e kundërta e pretendimit sipas elaborimeve në vijim.

Fillimisht duhet cekur se komisioni i vlerësimit ka publikuar raportin e vlerësimit me datë 02.03.2023 sipas të cilit për këtë aktivitet të prokurimit janë vlerësuar si të përgjegjshëm gjashtë (6) ofertues me çmimet si në vijim:

1. IPE-Proing Sh.P.K. me çmim 8.78;
2. IMK Ballkan Projekt Sh.P.K. me çmim 10.43;
3. ACT-ing Sh.P.K. & GEOKOS A & A O.P. me çmim 28.8;
4. N.Sh. Test&ing me çmim 30.75;
5. A.L.T.E.A. & GEOSTUDIO 2000 me çmim 39.74, si dhe
6. ECCT, A&A&D Kosova Sh.P.K. me çmim 88.60.

Kriteri i përzgjedhës për rekomandimin e tenderuesit sipas njoftimit për kontratë është “operatori ekonomik i përgjegjshëm me çmimin më të lirë” (ky fakt nuk kontestohet as nga parashtruesi). Sipas këtij kriteri dhe duke marrë parasysh raportin e vlerësimit të ofertave, rezulton se operatori ekonomik i përgjegjshëm me çmimin më të lirë është IPE Proing Sh.P.K. me çmimin 8.78. Megjithatë, komisioni i vlerësues me datë 02.03.2023 ka publikuar njoftimin për vendim ku ka ndodhur një gabim teknik meqë nuk është rekomanduar si tenderues i suksesshëm operatori ekonomik (i përgjegjshëm) me çmimin më të lirë por është rekomanduar operatori ekonomik me çmimin e dytë më të lirë që në këtë rast është IMK Ballkan Projekt Sh.P.K. me çmim 10.43 (parashtruesi). Mirëpo të njëjtën ditë pas pak orëve, komisioni vlerësuar në konsultim edhe KRPP (Komisionin Rregullativ për Prokurimin Publik) menjëherë ka korigjuar gabimin teknik që ka ndodhur. Në këtë mënyrë me datë 02.03.2023 është publikuar B54-Letër standarde për tenderuesin e suksesshëm për korigjimin e njoftimit mbi vendim të autoritetit kontraktues së bashku me njoftimin për vendimin e korigjuar të autoritetit kontraktues përmes të cilit si tenderues i suksesshëm është rekomanduar IPE Proing Sh.P.K. si operatori ekonomik i përgjegjshëm me çmimin më të lirë.

Vlen të theksohet se parashtruesi në pretendimin e tij nuk e kundërshton faktin se IPE Proing Sh.P.K. është operator ekonomik i përgjegjshëm dhe ka ofertuar me çmim më të lirë se parashtruesi. Parashtruesi në pretendimin e tij vetëm aludon se autoriteti kontraktues e ka rekomanduar parashtruesin si tenderues të suksesshëm dhe e konteston faktin që autoriteti kontraktues e ka rekomanduar IPE Proing Sh.P.K. si tenderues të suksesshëm. Megjithatë, elaborimi më sipër e sqaron mjaftueshëm gabimin teknik që ka ndodhur nga komisioni vlerësues dhe i cili gabim është përmisuar të njëjtën ditë.

Pas analizimit të kërkesës për rishqyrtim e datës 06.03.2023 është gjetur se pretendimi i parashtruesit është i pabazuar dhe si i tillë është refuzuar në kuptim të nenit 62 paragrafit 62.1. nën paragrafi d) të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik.

Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 paragrafin 63.1. nënparagrafin 63.1.1. pikën a) lidhur me nenin 62 paragrafin 62.1. nënparagrafin d) të RRPP. Për pikën III dhe pikën IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 paragrafin 2. të RRPP.

Bazuar në të thënat më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Prishtinë, 10.03.2023

Visar SHEHU

Ud. Udhëheqës i Sektorit të Prokurimit  
Komuna e Prishtinës

#### **Këshillë juridike:**

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqes ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimit të këtij vendimi sipas LPP.